



ГРАД СКОПЈЕ

Nr. _____

Скопје

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 5/02), dhe në përputhje me Kreun IV – a të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018 dhe 198/2018 dhe „Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.143/2019), dhe në lidhje me Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Qytetin e Shkupit nr.08-4042/1 të datës 08.05.2018, nr.08-4042/2 të datës 01.08.2018, nr.08-4042/3 të datës 14.09.2018, nr.08-4042/6 të datës 05.10.2018, nr.08-4042/8 të datës 07.11.2018, nr.08-4042/11 të datës 14.12.2018, nr.08-4042/14 të datës 22.01.2019, nr.08-4042/17 të datës 26.07.2019, nr.08-4042/20 të datës 03.09.2019, nr.08-4042/23 të datës 18.09.2019, nr.08-4042/26 të datës 08.10.2019, dhe nr.08-4042/29 të datës 18.12. 2019 dhe Vendimit për përcaktimin e nevojës për pranimin e punëtorëve nr. 08-_____/1 të datës _____. 2020, Qyteti i Shkupit, publikon

SHPALLJE PUBLIKE nr.01/2020 për punësim të punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar

Përcaktohet nevoja për punësim të punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar në vendet e punëve të mëposhtme:

1. Emërtimi i vendit të punës **Shofer**, shifra UPRO403A03001, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i kryerësve (1)** - kombësia 1 (një) shqiptar/e

Kandidatët është e nevojshme të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë të pjekur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të posaçme:

- të ketë përfunduar të paktën arsimin e mesëm
- me ose pa eksperiencë pune

Kushte të tjera të posaçme

- patentë shoferi të kategorisë „B”

Vlera në të holla e pagës themelore neto për vendin e punës Shofer është 17.244 denarë.

Orari i punës është nga ora 8:30 deri në orën 16:30 nga e hëna deri të premten, pikërisht 40 orë në javë

2. Emërtimi i vendit të punës Sigurimi i objekteve, shifra UPRO402A03001
Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i kryerësve (3)** - kombësia 3 (tre) maqedonas/e

Kandidatët është e nevojshme të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë të pjekur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të posaçme:

- të ketë përfunduar të paktën arsimin e mesëm
- me ose pa eksperiencë pune

Kushte të tjera të posaçme:

- licencë për sigurimin e pronave dhe personave

Vlera në të holla e pagës themelore neto për vendin e punës Sigurimi i objekteve është 17.244 denarë

Orari i punës është me turne 12 orë punë, 24 pushim, 12 orë punë, 48 pushim,

3. Emërtimi i vendit të punës Korrier, shifra UPRO405A03001, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, Numri i kryerësve (1) – kombësia 1(një) kombësi të tjera

Kandidatët është e nevojshme të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë të pjekur,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

Kushte të posaçme:

- të ketë përfunduar të paktën arsimin fillor
- me ose pa eksperiencë pune

Kushte të tjera të posaçme

patentë shoferi të kategorisë „B”

Vlera në të holla e pagës themelore neto për vendin e punës Korrier është 14.500 denarë.

Orari i punës është nga ora 8:30 deri në orën 16:30 nga e hëna deri të premten, 40 orë në javë.

Kandidatët mund të shkarkojnë **FLETËPARAQITJE PËR PUNËSIM të personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit nr.01/2020 nga ueb-faqja e Qytetit të Shkupit** www.skopje.gov.mk ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën Bul. Ilinden nr.82, Shkup.

Kandidatët janë të detyruar përveç Fletëparaqitjes për punësim sipas shpalljes publike nr.01/2020, të depozitojnë edhe dëshmi për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura në origjinal ose kopje të noterizuara si më poshtë:

- dëshmi për shtetësi;
- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënimi ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e shkallës adekuate të arsimit;
- dëshmi për aftësi shëndetësore dhe psiko-fizike nga institucion i autorizuar shëndetësor në përputhje me ligjin.

Kandidatët nëse kanë eksperiencë pune është e nevojshme të depozitojnë edhe dëshmi për eksperiencë pune të evidentuar në Agjencinë për Punësime.

Vërejtje: Në përputhje me Planin vjetor për punësime në Qytetin e Shkupit për vitin 2020, në Shpalljen publike të publikuar për vendin e punës nën numrin rendor 1. **Shofer** – 1 kryerës duhet të punësohet 1(një) shqiptar, për vendin e punës nën numrin rendor 2. **Sigurimi i objekteve** duhet të punësohen 3 (tre) maqedonas/e, për vendin e punës nën numrin rendor 3. **Korrier** duhet të punësohet 1 (një) nga kombësi të tjera.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. Ilinden nr. 82, Shkup me shënimin - për **SHPALLJE PUBLIKE nr.01/2020 për punësim të punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar.**

Afati për aplikim është 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes. Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e depozitimit të fletëparaqitjes.

Vërejtje: Nëse kandidati në fletëparaqitje nuk ka paraqitur të dhëna për kontakt (numër telefoni ose e-mail) fletëparaqitja do të refuzohet.

Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:

Faza 1: kontrolli i aplikimeve dhe dëshmive – realizohet në afat kohor prej 3 ditësh nga dita e shpalljes së publikuar. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni përzgjedhës do ta kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose telefonit në fletëparaqitje dhe ai në afat prej tri ditësh duhet t'i kompletojë

dëshmitë, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe në rastin kur dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: intervistë me kandidatët e përzgjedhur – realizohet në afat prej 10 ditësh pas realizimit të fazës së dytë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës për përzgjedhje janë të përcaktuara me **RREGULLOREN për punësimin e personave ndihmës – teknikë** në Qytetin e Shkupit, e cila është publikuar në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

E depozituar pranë:

- Sloboden pečat
- Nova Makedonija
- Koha

QYTETI I SHKUPIT
Kryetari

Petre Shilegov